

AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"LUZI 1" shpk

Sot, më 10.10.2024 unë, themeluesi, **Shkëlqim Luzi**, atësia Jakup, shtetas shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi H01122086T, i datëlindjes 22.11.1970, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, kam vendosur:

**Neni 1**

**Themelimi**

1. Emri i shoqërisë është "**LUZI 1**" shpk.
2. Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
3. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:**

**Objekti**

1. Shoqëria "**LUZI 1**" shpk, do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Në fushën e ndërtimit të objekteve sociale kulturore, të banimit, private apo shtetërore mbi bazën kontraktuale, në përmbushje të detyrimeve dypalëshe dhe shumë palëshe. Në investimin dhe bashkë investimin e objekteve të ndërtimit. Fushat e veprimtarisë janë ndërtimi i objekteve të ndërtimit, zbatimim në ndërtim, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve, ndërtime dhe sistemime në infrastrukturë, dizinjimi i brendëshëm dhe i jashtëm i objekteve të ndërtimit, të vjetra dhe të reja, shitja e produkteve dhe shërbimeve të ndërtimit, real estate, punime hidraulike dhe të ngrohje ftohjes, punime dhe prodhime të duroaluminit dhe punimeve me kartonxhes, punime të xhamit, veshjeve, dekoracioneve etj. Tregëtimi dhe trajtimi i të gjitha produkteve që përdoren në ndërtim.

**Neni 3:**

**Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:**

**Selia**

1. Shoqëria e ka selinë në: Rruga "Komuna Dajt, Fshati Shtëpaz", Tiranë, Shqipëri.



2. Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

#### Neni 5

##### Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (njëqindëmijë) lekë dhe përbëhet nga 1(një) kuotë, kontribut i ortakut të vetëm.
2. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme, të paluajtshme apo të drejta).

#### Neni 6

##### Administratori

1. Administratori i shoqërisë emërohet **Shkëlqim Luzi**, atësia Jakup, shtetas shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi H01122086T, i datëlindjes 22.11.1970, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me afat emërimi 5 vjeçar.

#### Neni 7

##### Baza Ligjore

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 8

##### Mosmarrëveshjet

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

### ORTAKU I VETËM

### I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“LUZI 1” shpk

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Shkëlqim Luzi

SHKËLQIM LUZI

